32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

## **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Gjuha Shqipe.</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 11 muaj.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Kontarktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rëndë dakord mes paleve kontraktuese;</li> <li>- Do të sigurojë për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara;</li> <li>- Duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës në qoftë se për kryerjen e punëve duhet të përdoren pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj. varesisht nga natyra e këtij aktivitetit te prokurimit.OE duhet të siguroj mjetet e domosdoshme per pune që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj;</li> <li>-Do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim;</li> <li>- Do të sigurojë sigurinë në Vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit -do të mbajë një regjistër të punëve në rast të kontratave për punë.</li> </ul> <p><i>(iii)Përpos sigurisë në nenet e lartëpërmendura të kësaj kontrate parashihet edhe mbrojtja e shëndetit të punëtorëve të kontraktuesit: ku do të zbatohen dispozitat pozitive të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin e punëtorëve në punë në fuqi dhe nese vjen deri të ndonjë rast do të zbatohen dispozitat e</i></p>

		<i>këtij Ligji respektivisht Neni 8 par.4. dhe çdo dispozitë e këtij ligji që ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve dhe në rast se ndodh rasti përgjegjësinë e mban kontraktuesi dhe nënkontraktuesi</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është <b>15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.</b>
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>[shëno datën kur do të filloj ekzekutimi i kontratës]</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>[ 10 Muaj]</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</b>  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresën e Menaxherit të Projektit]</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% i vlerës së kontratës.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është <i>[24 muaj]</i>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.



		<p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës</b> në kuadër të <b>Odës Ekonomike të Kosovës</b>, në përputhje me rregullat e <b>Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë</b>.</p> <p><b>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</b></p>
--	--	--

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

**Objekti:** Qerdhja për femijë P+0

**Lokacioni:** Lagjja 2 - Skenderaj

**Investitor:** Komuna Skenderaj

**Vërejtje:** Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje

A ARKITEKTURA & STRUKTURA					
Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.		Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH
<b>I PUNËT PËRGADITORE DHE DEMOLUESE</b>					
1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë, largimi i instalimeve të vjetra nëse ka brenda dhe rreth hapësirës e cila do të shfrytëzohet për punë.	cope	1.00	5,000.00 €	5,000.00 €
1.2	Hapja e kantierit për punë, pozicionimi i kabinës për inxhinierë dhe staf, vendosja e tabelës informuese për projekt, vendosja e WC, shenja paralajmëruese për kujdes dhe rregulla për punishte. Rrethimi me shirita dhe rrjeta sipas nevojës për gjithë hapësirën e cila përdoret për punë.	cope	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.3	Shënimi gjeodezik i projektit në terren, të bëhen matje të sakta të pikave të nevojshme për ekzekutim edhe nëse ato pika nuk janë të përfshira në projekt. Në çmim të llogaritet dhe përcjellja e punëve ndërtimore me instrumente gjeodezike.	cope	1.00	2,000.00 €	2,000.00 €
1.4	Demolimi dhe largimi i mbeturinave të ngurta në hapësirën në të cilën do të kryhen punimet, mbetje nga Betoni i Armuar, PVC, Çeliku, Xhami e të ngjashme të cilat pengojnë në fillimin dhe ngritjen e ndërtesës. Në çmim të përfshihen të gjitha materiet që mund të gjenden në terren, transporti dhe hudhja deri në deponi të caktuar nga organi mbikqyrës. Kujdes i veçantë t'i kushtohet gjelbrimit, të ruhen drunjtë ekzistues dhe të zhvendosen sipas projektit detal.	cope	1.00	2,000.00 €	2,000.00 €
1.5	Demolimi dhe largimi i mureve ekzistuese nga argjila, muret që largohen janë mure ekzistuese të punuara jashtë standartit dhe jashtë normave ndërtimore. Në pozicion përfshihen muret me trashësi 20cm dhe 25cm në të gjithë hapësirën e objektit në vendet ku autoriteti kontraktues respektivisht organi mbikqyrës e sheh që është punuar jashtë standarteve	m <sup>2</sup>	830.00	1.00 €	830.00 €
1.6	Demolimi dhe largimi i pllakes në nivelin +5.60 nga baza, pllaka është në lartësi jo të pershtatshme për qëndrim dhe qarkullim ditor, niveli i kësaj pllake duhet të ngritet në nivelin e duhur në mënyrë që lartësia e katit të jetë me standarte	m <sup>2</sup>	30.00	100.00 €	3,000.00 €
1.7	Demolimi dhe largimi i izolimeve nga terasat e planifikuara për gjelbrim, në pozicion të përfshihet edhe gryerja e të gjitha mbetjeve të izolimit në betonin e pllakes së katit në mënyrë që shtresa e re izoluese të jetë e vendosur sa më mirë dhe sipas rregullave. Largimi i materialit të dërgohet në deponi	m <sup>2</sup>	450.00	8.00 €	3,600.00 €
1.8	Demolimi dhe largimi i mbuleses së qerdhes ( kulmit të objektit ) largimi i tij duhet të bëhet për arsye që brenda në objekt shihen rrjedhje të ujit të cilat vijnë si pasojë e vendosjes jo të rregullt të kulmit	m <sup>2</sup>	365.00	1.00 €	365.00 €
<b>TOTAL PUNËT PËRGADITORE DHE DEMOLUESE</b>					<b>17,795.00 €</b>



II PUNËT E GËRMIMIT DHE TERRENIT					
2.1	Gërmimi i shtresës së humusit në thellësi t=50-70 cm, sipas skicave dhe detaleve në projekt. Në llogari të përfshihet transporti deri në një deponi të caktuar nga organi mbikqyrës. Dheu i njëjtë të rikthehet në vend pas përfundimit të punëve, në çmim të përfshihet kostoja për rikthim, zgjedhja dhe selektimi i dheut të mirë, të përshtatshëm për mbjellje të barit në kulmin e gjelbërt apo pemëve sipas kërkesës.	m <sup>3</sup>	150.00	3.00 €	450.00 €
2.2	Gërmimi i thellë I dheut të kategorisë III dhe IV, për punimin e shtresavë të zhavorit dhe themeleve të ndërtesës. Gërmimi të bëhet sipas skicave dhe detaleve në projekt, në raste të disniveleve punëkryesi të ketë parasysh punën më instrumente gjeodezike dhe të ketë parasysh kuotat. Në llogari të përfshihet transporti dhe hudhja në deponi të caktuar nga organi mbikqyrës. Gërmimi është llogaritur në parterin e qerdes në trotualet dhe shtigjet e ecjen për femije	m <sup>3</sup>	700.00	3.00 €	2,100.00 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës, për të sjellë në formë të përshtatshme për punimin e shtresave. Në llogari të përfshihen dhe provat e ngjeshje nga kompani e licencuar për matje dhe moduli I ngjeshjes të arrihet sipas normave në fuqi. Çmimi të nxjerret për m2 të sipërfaqes së ndërtesës.	m <sup>2</sup>	850.00	1.00 €	850.00 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 250 gr/m2, materiali të prezantohet para inxhinierit mbikqyrës ndërsa mbulimi I dheut të bëhet sipas normave teknike në fuqi. Llogaria të bëhet për m2	m <sup>2</sup>	850.00	1.00 €	850.00 €
2.5	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit 0-63mm, me trashësi të shtresës t=25 cm. Moduli I ngjeshjes deri në masë densiteti të kërkuar Mv=60MPa. Në çmim të llogaritet dhe testimi nga kompani e licencuar për matje gjeomekanike.	m <sup>3</sup>	350.00	16.00 €	5,600.00 €
2.6	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit 0-31mm, me trashësi të shtresës t=15 cm. Moduli I ngjeshjes deri në masë densiteti të kërkuar Mv=80MPa. Në çmim të llogaritet dhe testimi nga kompani e licencuar për matje gjeomekanike.	m <sup>3</sup>	18.00	18.00 €	324.00 €
2.7	Furnizimi, transporti, vendosja e skajoreve me dimensione 10x20x100cm për shtigjet e ecjes për femije dhe staf të qerdes	m'	220.00	12.00 €	2,640.00 €
2.8	Furnizimi, transporti, vendosja e reres se imet për nivelimin e bazës para vendosjes së kubzave fraksion 4-8mm	m <sup>2</sup>	700.00	6.00 €	4,200.00 €
2.9	Furnizimi, transporti, vendosja e kubzave me trashësi t=8cm për shtigjet e ecjes, dizajni dhe lloji I kubzave përcaktohet nga investitori respektivisht nga organi mbikqyrës	m <sup>2</sup>	550.00	20.00 €	11,000.00 €
3.0	Furnizimi, transporti, vendosja e reres se imet 0-2mm pas vendosjes së kubzave. Në pozicion të përfshihet edhe rivendosja disa herë e reres deri sa të mbyllet futat ndarsë të kubzave.	m <sup>2</sup>	550.00	6.00 €	3,300.00 €
4.0	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dheut në të gjithë hapsirën gjelberuese dhe të planifikuar me gjelbrim në çmim të përfshihet edhe mbjellja e barit me cilësore në treqe si dhe mirembajtja e barit në faza dhe kushte optimale	m <sup>2</sup>	5,500.00	5.00 €	27,500.00 €
<b>TOTAL PUNËT E GËRMIMIT DHE TERRENIT</b>					<b>58,814.00 €</b>



III PUNËT E BETONIT					
3.1	Furnizimi, transporti dhe vuarja në vepër e beton të varfër, me trashësi të shtresës t=5cm. Betoni të shërbejë si shtresë mbrojtëse për pllakën e themelit.	m <sup>3</sup>	20.00	65.00 €	1,300.00 €
3.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës së themelit, beton I klasës C-25/30. Më parë të bëhet kallëpimi, vendosja e pahive, skeleve dhe elementeve tjera të nevojshme. Në llogaritje merren dhe hapjet (vrimat) sipas kërkesave arkitektonike (shiko arkitekturën).	m <sup>3</sup>	15.00	120.00 €	1,800.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave të betonit, beton I klasës C-25/30. Më parë të bëhet kallëpimi, vendosja e pahive dhe elementeve të nevojshme.	m <sup>3</sup>	4.00	120.00 €	480.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe betonimi i trajeve të betonit, beton I klasës C-25/30. Më parë të bëhet kallëpimi, vendosja e pahive, skeleve dhe elementeve të nevojshme.	m <sup>3</sup>	10.00	120.00 €	1,200.00 €
3.5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës së meskatit të betonit, beton I klasës C-25/30. Më parë të bëhet kallëpimi, vendosja e pahive, skeleve dhe elementeve të nevojshme.	m <sup>3</sup>	10.00	120.00 €	1,200.00 €
3.6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shkallëve të betonit, beton I klasës C-25/30. Më parë të bëhet kallëpimi, vendosja e pahive, skeleve dhe elementeve të nevojshme.	m <sup>3</sup>	4.00	120.00 €	480.00 €
3.7	Atestet e nevojshme mbi kualitetin e betonit, matja e konsistencës, marrja e mostrave të betonit dhe shqyrtimi i tyre nga kompania e licencuar për këto punë. Në çmim të llogariten një numër mostrash sipas standardeve dhe normave në fuqi.	cope	1.00	500.00 €	500.00 €
3.8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit të varfër klas C16/20 me trashësi t=10cm si baze për themelin e mureve mbrojtëse	m <sup>3</sup>	15.00	80.00 €	1,200.00 €
3.9	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për themelet e mureve mbrojtëse klase C30/37 me trashësi dhe specifikacione sipas projektit	m <sup>3</sup>	110.00	150.00 €	16,500.00 €
4.0	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit klase C30/37 për implementimin e mureve mbrojtëse	m <sup>3</sup>	98.00	150.00 €	14,700.00 €
4.1	Furnizimi, dhe montimi i fugës së dilimit, fuga të punohet nga elementi i pershtatshëm-material elastik. Të respektohen distancat sipas projektit.	m'	20.00	10.00 €	200.00 €
<b>TOTAL PUNËT E BETONIT</b>					<b>39,560.00 €</b>



IV PUNËT E ARMIMIT					
4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e armaturës për armimin e elementeve prej betonit - themelet pllakës, shtyllave, trajeve, pllakes se katit, mureve mbrojtese, themeleve te mureve mbrojtese sipas projektit. Punimi dhe latimi i armaturës gjatësorë, tërthore, kryesore, stafa e të nevojshme. Armaturë me diametra Ø10mm; Ø12mm; Ø14mm; Ø16mm klasa e çelikut S-500B, duktiliteti I mesëm.	kg	22,500.00	1.90 €	42,750.00 €
<b>TOTAL PUNËT E ARMATURËS</b>					<b>42,750.00 €</b>
V PUNËT E MURATIMIT					
5.1	Furnizimi , transporti me material blloqe argjillore 'GJYSEMGITER" apo ekujvalent dhe muratimi i mureve te jashtme të objektit në trashësi të mureve D=25 cm nga dyshemeja deri nën pllakën e meskatit. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas tipit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjitës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim.	m²	450.00	6.00 €	2,700.00 €
5.2	Furnizimi , transporti me material blloqe argjillore 'GJYSEMGITER" apo ekujvalent dhe muratimi i mureve ndarëse të hapsirave të objektit në trashësi të mureve D=20 cm nga dyshemeja deri nën pllakën e meskatit. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas tipit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjitës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim.	m²	250.00	6.00 €	1,500.00 €
5.3	Furnizimi , transporti me material blloqe argjillore 'GJYSEMGITER" apo ekujvalent dhe muratimi i mureve ndarëse të hapsirave të objektit në trashësi të mureve D=12 cm nga dyshemeja deri nën pllakën e meskatit. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas tipit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjitës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim.	m²	50.00	6.00 €	300.00 €
5.4	Furnizimi transporti me material, elemente "SHUNT" të oxhaqeve të ventilimit . Oxhaqet te jene me dim. (25x20)cm dhe sherbjen per ventilimin e banjove, WC dhe kuzhinave. Punimi i oxhaqeve dhe muratimi i tyre të bëhen sipas standardeve dhe manuale për të funksionuar sa më mirë.	m'	30.00	12.00 €	360.00 €
5.5	Furnizimi transporti me material, elemente "SHUNT" të oxhaqeve të ventilimit. Blloqet te jene me dim. (20x20) cm dhe sherbjen per muratimin e mureve te fasades se jashtme. Muratimi te behet sipas skicave dhe detaleve në projekt. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas tipit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale me llaq vazhdues ose ngjitës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve.	m'	150.00	15.00 €	2,250.00 €
<b>TOTAL PUNËT E MURATIMIT</b>					<b>7,110.00 €</b>
VI PUNËT E SUVATIMIT					
6.2	Suvatimi i MUREVE TË MBRENDSHME me llaq vazhdues ne dy shtresa dhe me sperkatje paraprake më lëng çimentoje. Ne cmim hyn edhe skela e nevojshme! Sqarim; pllafoni eshte teksture e pastert betoni. Te punohet sipas planit detal.	m²	1,850.00	10.00 €	18,500.00 €
<b>TOTAL PUNËT E SUVATIMIT</b>					<b>18,500.00 €</b>



VII PUNËT E IZOLIMIT					
7.1	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në pllakën e themelit me material hidroizolues të tipit Kondor 5.0 mm. Së pari të bëhet përgatitja e sipërfaqes , pastaj të bëhet lyerja me bitulit të ftohtë dhe më pas izolimi i "kondorit" me flakë duke hudhur 10cm palën mbi palë. Gjatë punës të izolohehen me kujdes edhe këndet duke u vendosur ekstra izolim shtesë min 10cm. Te punohet sipas planit detal.	m <sup>2</sup>	300.00	8.00 €	2,400.00 €
7.2	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit vertikal në themel me material hidroizolues të tipit "Kondor" 5.00 mm duke filluar nga shputa e themelit dhe mbaruar 40cm mbi kuotën e tokës. Të bëhet pastrimi i sipërfaqes, lyerja me bitulit të ftohtë dhe më pas izolimi i "kondorit" me flakë duke hedhur 10cm palën mbi palë. Kujdes i vecantë të i kushtohet këndëve që të izolohehen ekstra me izolim shtesë. Pas hidroizolimit nën kuotën e tokës duhet vendosur edhe termoizolimi XPS 5cm (stirodur) dhe të mbrohen me shtresën mbrojtëse - fundolinën. Te punohet sipas planit detal arkitektonik.	m <sup>2</sup>	78.00	8.00 €	624.00 €
7.3	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në pllakën e meskalit-kulmi i gjelbërt me material hidroizolues të tipit Kondor 5.0 mm. Së pari të bëhet përgatitja e sipërfaqes , pastaj të bëhet lyerja me bitulit të ftohtë dhe më pas izolimi i "kondorit" me flakë duke hudhur 10cm palën mbi palë. Gjatë punës të izolohehen me kujdes edhe këndet duke u vendosur ekstra izolim shtesë min 10cm. Te punohet sipas planit detal dhe duhet te kihet parasysh detali i kulmit te gjelbert. Te behen konsultime per hidroizolim ne kulmin e gjelbert me firme perioioise qe mirret me kulme te oielberta.	m <sup>2</sup>	550.00	7.00 €	3,850.00 €
7.4	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit vertikal në themel me material hidroizolues të tipit "Kondor" 5.00 mm duke filluar nga pllaka e meskalit dhe ngritur 40cm mbi kuotën e pllakës. Të bëhet pastrimi i sipërfaqes, lyerja me bitulit të ftohtë dhe më pas izolimi i "kondorit" me flakë duke hedhur 10cm palën mbi palë. Të izolohehen dhe pjesët e trarëve në mes të pllakës, trarët në dy drejtimet (lartësia për izolim 40cm). Kujdes i vecantë të i kushtohet këndëve që të izolohehen ekstra me izolim shtesë.	m <sup>2</sup>	55.00	7.00 €	385.00 €
7.5	Furnizimi dhe vendosja e termoizolimit ne dysheme sipas planit detal (t= 3 cm).	m <sup>2</sup>	475.00	3.20 €	1,520.00 €
7.6	Furnizimi dhe vendosja e PVC folies ne shtresen e betonit si pengese kunder avullit	m <sup>2</sup>	475.00	1.50 €	712.50 €
7.7	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës rrafshuese "ESTRIH" në dyshemetë e objektit. Shtresa rrafshuese Estrih të punohet në trashësi T= 5 cm dhe e armuar me rrjetë "RABITS" . Sipërfaqja e Estrihut duhet të ndahet me fugë dilatuese ose të pritët pas punimit. Sqarim; tek kuzhina kryesore dhe WC-te perballe kuzhines 'estrihu' eshte T=10 cm. Te punohet sipas detaleve ne projektin zbatues.	m <sup>2</sup>	930.00	10.00 €	9,300.00 €
7.8	Furnizimi dhe vendosja e izolimit te ftohte ne dysheme dhe mure deri tek pllafoni ne te gjitha hapesirat e WC-ve dhe banjove. Te punohet sipas planit detal.	m <sup>2</sup>	225.00	5.00 €	1,125.00 €
7.9	Furnizimi dhe vendosja e TERRACERIT ne te gjitha hapesirat ku kemi kontakt me ujin, ne banjo, wc-te, kuzhine dhe hapesirat e mini-kuzhinave. Te vendoset me ngjites adekuat per terracer dhe vendosja behet nga dyshemeja deri ne pllafon ne te gjitha muret. Materiali ne fjale eshte ne kove dhe vendoset ne veper ngjajshem me izolimin e ftohte. Ngjyra e terracerit eshte Te punohet sipas planit detal dhe ne konsultim me mbikqyresin e projektit.	m <sup>2</sup>	445.00	16.00 €	7,120.00 €
<b>TOTAL PUNËT E IZOLIMIT</b>					<b>27,036.50 €</b>



VIII PUNËT E ZDRUKTHTARISË					
Dritaret					
	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga profili i aluminit (te mveshura me teksture te drurit) me trashësi t=8cm me 3 ura termike. Profilët dhe mekanizmi montues të jetë prodhim i vendeve të BE-së. Te kompletohet me mekanizëm , bagllama dhe dorezë për hapje dhe mbyllje. Hapje normale, rrëshqitëse dhe hapje kiper me gomë perimetrike për mbyllje hermetike (shih detalin e hapjeve). Te merret parasysh se ne kuader te emrimit te dritareve jane te vendosura se bashku me dyer nga xhami. Po ashtu, kornizat e hapjeve te behen sipas detaleve ne projekt. Te punohet sipas planit detal arkitektonik. Xhami transparent (pa ngjyrë) 4X12(hapësira e lirë me mbushje Argoni )X4mm. Dritare të kualitetit të lartë A1				
8.1	D-01 /200x270/ cm	copë	12.00	620.00 €	7,440.00 €
8.2	D-02 /165x150/ cm	copë	6.00	380.00 €	2,280.00 €
8.3	D-03 /220x150/ cm	copë	2.00	420.00 €	840.00 €
8.4	D-04 /190x80/ cm	copë	1.00	280.00 €	280.00 €
8.5	D-05 /140x50/ cm	copë	1.00	230.00 €	230.00 €
8.6	D-05 /130x270/ cm	copë	2.00	470.00 €	940.00 €
8.7	D-05 /170x270/ cm	copë	2.00	550.00 €	1,100.00 €
8.8	D-05 /210x270/ cm	copë	2.00	600.00 €	1,200.00 €
8.8	D-05 /270x270/ cm	copë	4.00	840.00 €	3,360.00 €
8.8	D-05 /150x150/ cm	copë	7.00	370.00 €	2,590.00 €
<b>Dritare me katrore si ne projekt</b>					
8.1		copë	1.00		0.00 €
8.1	D-06 /380x270/ cm	copë	2.00	820.00 €	1,640.00 €
8.1	D-07 /370x200/ cm	copë	1.00	750.00 €	750.00 €
8.1	D-08 /320x200/ cm	copë	2.00	650.00 €	1,300.00 €
8.2	D-09 /260x200/ cm	copë	2.00	420.00 €	840.00 €
<b>Dyert</b>					
8.2	D-10 /90x270/ cm	copë	21.00	350.00 €	7,350.00 €
8.2	D-11 /80x270/ cm	copë	10.00	340.00 €	3,400.00 €
8.2	D-12 /240x270/ cm	copë	1.00	720.00 €	720.00 €
8.2	D-13 /220x210/ cm	copë	1.00	400.00 €	400.00 €
<b>TOTAL PUNËT E ZDRUKTHTARISË</b>					<b>36,660.00 €</b>



IX PUNËT E DYSHEMESË BRENDA OBJEKTIT					
